



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Br	27351/26
Nr. i fq. / Br. st	- 5 -
Data: / Datum	30. 06. 2026
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vuçitrn-Municipality of Vushtri

**Procesverbali nga takimi i parë publik me qytetarë i Kryetarit të Komunës për punën
gjashtë mujore Janar - Qershor 2026**

Qershor, 2026

PROCESVERBAL

Nga takimi i parë publik me qytetarë i kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për punën gjashtë mujore Janar - Qershor 2026.

Datë: 26.06.2026

Ora: 11:00

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës

Takimi është hapur nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, i cili para qytetarëve të pranishëm ka prezantuar raportin për punën gjashtë mujore (Janar - Qershor 2026) të ekzekutivit.

Të pranishëm kanë qenë edhe të gjithë drejtorët e drejtorive.

Ferit Idrizi, kryetar i Komunës së Vushtrrisë, mirë se keni ardhë në takimin e parë publikë me qytetarë, ku do të prezantojmë aktivitetet dhe projektet e përfunduara gjatë këtij gjashtëmujori të parë të vitit 2026.

Përveç këtij takimi që është obligativ, unë kam takime me qytetarët çdo muaj, vetëm sot i kam pritur rreth 40 qytetarë në zyrën tim që nga mëngjesi. Po ashtu, i shfrytëzoj edhe rrjetet e mia sociale që të jem sa më afër qytetarëve.

Bashkë me mua janë edhe drejtorët e drejtorive komunale, të cilët gjithashtu mund të përgjigjen në pyetjet dhe kërkesat tuaja.

Para juve do të paraqes një përmbledhje të punëve dhe aktiviteteve të përfunduara gjatë këtij gjashtë mujori të parë të vitit 2026.

Në Drejtorinë e Arsimit, kemi ndarë 14 bursa për studentët e Vushtrrisë në Kampusin Evropian të Universitetit të York-ut në Selanik, për studime Bachelor, Master dhe MBA, në programet: Shkenca Kompjuterike (Inteligjencë Artificiale dhe Shkenca e të Dhënave, Teknologjitë e Web-it, Informatikë Biznesi), Psikologji, Biznes, Shkenca Humane dhe Drejtësi.

Kemi organizuar garat e diturisë në shkollat e Vushtrrisë, kemi bërë rregullimin e fushave sportive në Gjimnaz dhe rregullimin e fushës sportive në SHMU1.

Punë më shumë kemi pas në Drejtorinë e Shërbimeve publike sepse janë shërbime të qytetarëve. Kemi kërkesa për ujësjellës, kanalizim, për rregullim të rrugëve. Jemi duke punuar në atë drejtim, jemi duke e rregulluar parkun e qytetit, sigurisht edhe ju e keni pa se pak janë zvarritë punimet për shkak të kontratës kolektive dhe për këtë janë në dijeni edhe qytetarët. Prej vitit 2022 deri në këtë vit për kontratën kolektive janë paguar 13.553.000,00 euro, që është një shumë shumë e madhe e mjeteve, sepse ne për një vit e kemi buxhetin për investime kapitale 5.032.000,00 euro deri në 5.500.000,00 euro.

Është rregulluar edhe vigu që lidhë shëtitoren "Enver Zymberi" me pjesën e shëtitores tjetër. Edhe te vigu i Novolanit ka pas mbetur pa u kryer një pjesë për shkak të mungesës së mjeteve dhe tani po kryhen edhe anësoret dhe është një vig që shfrytëzohet prej pjesës së Artakollit në drejtim të Vushtrrisë dhe anasjelltas.

Kemi punuar në rikonstruimin e rrugës “Shotë Galica”, “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”, “Haxhi Zeka” dhe në disa rrugë nëpër fshatra, zgjerimin e disa rrugëve dhe parkingjeve, zgjerimin e ndriçimit publik në fshatin Sfaraçak, Bukosh, Akrashticë, Samadrexhë, Zhilivodë, Pestovë, Studime, Shtitaricë, Vilanc.

Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatrat Dubovc, Galicë, Beqiq. Ende nuk është lëshuar uji, ka mbet edhe pak punë për me e lëshuar ujin. Shtrirja e gypit të ujësjellësit në drejtim të fshatrave Sfaraçak, Samadrexhë, Ropicë, Stanoc, Gracë. Është projekti i madh që kemi filluar me bazene, është duke u punuar edhe në bazenin akumulues.

Te Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit është punuar në renovimin e banesave kolektive që ne i quajmë banesat e bardha, por nuk janë vetëm banesat e bardha por janë edhe disa banesa në pjesën e qytetit kah ura e hekurit, të cilat banesa kanë qenë në gjendje shumë të keqe dhe të dëmtuara dhe me të vërtetë banorët e kanë pas një jetë të vështirë. Jemi në fazën finale të kryerjes së këtyre banesave.

Janë duke vazhduar punimet edhe në sheshin “Adem Jashari”, edhe këtu jemi vonuar për shkak se nuk kemi pas mjete me i paguar për punën që e ka bërë operatori dhe është dashtë me e zgjatë afatin e kontratës.

Është ndërtuar shkolla e re “Mustafë Venhari”. Na ka mbetur veç edhe një trafo sepse kushtet teknike të KEDS-it nuk na kanë lejuar me e lidhë nga shkolla e vjetër por na e kanë qitë kusht me e vendosë një trafo të re.

Ka përfunduar asfaltimi i rrugës “Drenica”, është punuar mirë në këtë rrugë, janë mbjellë edhe drunjtë dekorativ, vazhdimisht bëhet ujitja e drunjëve nga kompania. Kjo rrugë e ka lehtësuar qarkullimin edhe të automjeteve dhe udhëtarëve.

Janë duke vazhduar punimet edhe në rrugën Vushtri-Skoçan, është një projekt që edhe pse nuk ka popullatë, është një projekt për zhvillimin e agroturizmit.

Po vazhdon puna në rrethojat e çelikut te ura e lumit “Silnica”, edhe këtë projekt e kemi premtuar, i cili ka pas me u krye më herët por në mungesë të mjeteve është zvarritë.

Një rëndësi e veçantë po i kushtohet përmirësimit të furnizimit me ujë të pijshëm në pjesën perëndimore të qytetit. Kemi vendosë shumë pompa dhe ato do të jenë aktive deri sa të bëhen bazene të mëdha. Një bazen ka me u ndërtu në Sllatinë, Samadrexhë dhe një tjetër.

Në zonat rurale komuna është në përfundim të asfaltimit të rrugëve. Na ka mbetur një rrugë në fshatin Stanoc i Poshtëm në lagjen “Muhaxheri”, ka qenë shumë e ngushtë ajo rrugë e tani është zgjeruar, por ka mbet vetëm shtresa e asfaltit me u vendosë. I kemi asfaltuar një numër bukur të madh të rrugicave në fshatin Novolan. E kemi zgjeruar rrugën “Dibran Imeri” në Pantinë, në mirëkuptim me qytetarë të cilët i kanë lëshuar pronat e tyre për zgjerim të rrugës. Edhe ajo pritet me u asfaltu shpejt.

Është punuar edhe në Tregun e Gjellbër, tash ka mbetur vetëm edhe hyrja në tregun e gjellbër. Po besoj se shpejt ka me u leshu në funksion.

Është punuar edhe në rrugën “Bekim Berisha” është bërë zgjerimi dhe unë i falënderoj të gjithë ata qytetarë të cilët kanë treguar mirëkuptim dhe kjo rrugë do të kryhet, por janë edhe disa mure që duhen të rrezohen, por jemi në fazën finale të shpronësimit të tyre.

Na ka mbetur keq rruga prej Nedakocit në drejtim të qytetit, është pronë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe ne edhe para dy ditëve kemi bërë kërkesë të na jepet në menaxhim sepse kanë ndodhë disa aksidente të rënda edhe për shkak të mosfunksionimit të semaforëve. Në momentin që na lejohet nga Ministria ne do të angazhohemi dhe në vendin e semaforëve do të vendosim rrethrotullim sepse janë më praktik.

Sa i përket Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim është punuar vite me radhë e edhe në këtë vit është punuar në pastrimin e lumenjve. Janë pastruar disa rrugë me qëllim të intervenimit të zjarrfikësve në rast nevojë. Janë menaxhuar shumë mirë vërshimet që i patëm në fillim të këtij viti për shkak të shirave të rrëmbyeshëm dhe Vushtrri ka menaxhuar shumë mirë këtë situatë. Është bërë vlerësimi i dëmeve të ekonomive familjare dhe të njëjtat janë përcjellë në ministri dhe presim me iu ndihmuar këtyre familjeve.

Te Drejtoria për Bujqësi, edhe pse kemi pas mungesë shumë të madhe të mjeteve dhe nuk kemi mundur këtë vit me shpallë konkurs për me ble as makineri e as sera, por u kemi paguar 50% të ujitje së tokave të cilat janë nën sistemin e ujitjes. I kemi hapë disa rrugë dhe i kemi shtruar me zhavor, rrugë të arave. I kemi edhe disa kërkesa për shtrimin e disa rrugëve të arave sepse është sezoni i korrje-shirjeve. Drejtoria për Bujqësi rregullisht ka mbajt takime me qytetarë, me të gjitha kategoritë: blegtorë, bletarë, bujq dhe është në fazën përgatitore sepse është sezoni i korrje-shirjeve dhe drejtori i Bujqësisë ka qenë vazhdimisht në teren me bujqit dhe na ka informuar për secilin detaj dhe kështu jemi të përgatitur për fazën e korrje-shirjeve. Kemi pas bashkëpunim me IADK-në në disa projekte me trajnime për përgatitjen profesionale të bujqve dhe fermerëve.

Te Drejtoria për Inspektive, po ashtu i kemi punë të përditshme, sidomos me këto pronat me uzurpimet që kanë qenë në rrënimin e mureve gjithçka është nën menaxhim në kuadër të kësaj drejtorie edhe pse kemi pas bukur vështirësi sidomos me shitësit çoftë të druve te QKMF-ja apo shpezëve dhe kemi kërkuar që të dalin në tregun e Bukoshit, sepse është rregulluar rruga “Drenica” dhe shumë shpejt mund të arrihet në tregun e Bukoshit. Kemi problem me shitësit të shtëpia e kulturës por tash me përfundimin e tregut të gjelbër edhe kjo pjesë do të pastrohet.

Te Drejtoria e Administratës janë duke u kryer punë të mira, një pjesë e shërbimeve janë të digjitalizuara. Qendra për Shërbimin me Qytetarë gjithmonë ka ofruar shërbime diku rreth 9933 shërbime për qytetar, shërbimi i gjendjes civile ka ofruar 39744 shërbime për qytetarë. Nuk kam pas asnjë ankesë prej qytetarëve sa i përket këtyre shërbimeve.

E kemi edhe Drejtorinë për Diasporë, drejtori i ka pas disa takime dhe vizita dhe janë bërë përgatitjet për pritjen e diasporës. Zakonisht Vushtrria ka ofruar shërbime për diasporë në administratë edhe ditëve të shtuna në atë mënyrë që ata të kenë mundësi ti marrin shërbimet dhe të kryejnë punë sepse dikush vjen për një javë ditë dhe ata duhet të marrin shërbime. Edhe organizimet tjera siç është festivali i diasporës përgatitjet janë bërë në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës.

Sa i përket Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, janë bërë shumë aktivitete, kemi pas shumë konferenca shkencore ndërkombëtare. Vushtrria është qyteti i vetëm që organizon konferenca shkencore, deri tani janë organizuar 10 konferenca shkencore ndërkombëtare me tema të ndryshme në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, ku kanë marrë pjesë shumë studiues nga të gjitha trevat shqiptare, mandej janë organizuar koncerte madhështore sidomos për ditën e çlirimit të Vushtrrisë. Ka shumë aktivitete dhe po dua me ju dhënë mundësinë juve me i shprehë shqetësimet e juaja. Sa i përket sporteve, klubi i futbollit ka hy në superligë. Nuk e kemi gjendjen e mirë financiare, edhe pse kemi siguruar sponsor prapë i kanë disa telashe dhe jemi në përpjekje me gjet zgjidhje edhe për ta. Ka filluar ndërtimi i ri i stadiumit të futbollit dhe ne jemi duke e përgatitë një stadium alternativ në fushat e Dobërlukës në mënyrë që mos me u ndalë aktivitetet.

Këto janë disa nga aktivitetet që i kemi kryer në këtë gjashtëmuor me qeverinë komunale dhe ju falënderoj juve që jeni pjesëmarrës këtu dhe pa humbur kohë fjalën ua kisha kaluar juve për me i dëgju hallet dhe shqetësimet e juaja. Ju faleminderit.

Më pas fjala ka kaluar te qytetarët pjesëmarrës në këtë takim për të paraqitur kërkesat e tyre.

Faik Morina, banor i fshatit Pantinë, problemin më të madh e kemi me kanalizimin, që tri vite në rrugën Pantinë–Oshlan i kanë qitë mbeturinat e banorëve në arën e nipit Myzafer Morinës. Problemi i dytë është me rrymë dhe telefon, merre me mend një metër e gjysmë e ka telin nalt pronari që e punon tokën bujqësore. Kërkojmë mirëkuptim të vini dhe ta shikoni këtë gjendje. Ju kisha lutë me mirëkuptim me ardhë me e shiku gjendjen dhe me e përfundu punën. Ju falënderoj.

Zyla Shabani, banore e Vushtrrisë, jetoj në Vneshtë, në rrugën “Shotë Galica”, nuk kam pas asnjë ndihmë pas lufte, vetëm KFOR-i francez më ka ndihmuar dhe më kanë thënë se ke të drejt me e lypë dëmin e luftës.

Gazmend Curri, banor i fshatit Reznik, e kam një kërkesë, prej pas lufte është e vetmja lagje që nuk ka kanalizim. Problemi tjetër është shkolla që funksionon në fshat punon pa komplet stafin e mësimitdhënësve, tani momentalisht kemi mungesë për ciklin e lartë në lëndën e historisë. Kam ardhë dhe jam ankuar edhe për mësimitdhënësit tjerë të cilët e kanë lënë punën dhe kanë shkuar në perëndim, por ky është problem i tyre por ata nuk kanë qenë në vendin e punës. Dhe kërkesa e tretë është për rrugën prej çeshmes së Vërnicsë deri në Shallc prej që është shtruar nuk është renovuar kurrë, kemi probleme se ka shumë gropa.

Adil Isufi, banor i fshatit Gojbulë, e kam pas një problem me rrugë për shkak se është dëmtuar shumë, është një rrugë diku rreth 400 metra.

Ramadan Nasufi, banor i fshatit Mihaliq, vitin e kaluar kanalizimi është kryer në tërë fshatin përveç disa shtëpi që na kanë lanë. Një lagje është Nasufi, vetëm një shtëpi e ka të kryer kanalizimin. Unë e kam qitë deri në stom të rrugës dhe tani po del në asfalt kanalizimi. Pra prej 8 shtëpive në lagje vetëm një e ka të kryer kanalizimin. Pra po pyes a kryhet kjo punë apo duhet vet ta kryejmë.

Brahim Manovi, banor i fshatit Duboc, jam kryetar i bashkësisë lokale i 4 fshatrave Beçiq, Galicë, Duboc dhe Taraxhë. Meqenëse keni punuar bukur mirë sepse kam qenë pak në perëndim dhe kam pa dhe Vushtrria me të vërtetë po lulëzon. Na e kemi një kërkesë shumë të vogël, kemi

rrjetin e rrymës shumë të dobët. Dhe e kemi një kërkesë të kamotshme për një rrugicë të vogël në lagjen Manovi dhe e cila qe 22 vjet gjithmonë është premtuar por nuk është realizuar.

Hilmi Mulaku, banor i Vushtrrisë, kam ardhë para 5-6 muajve për disa pengesa. Dy here më kanë hy në lokal dhe shtëpi, kjo është rruga “Vëllezërit Gërvalla”, te xhamia. Është një gropë të cilën disa here vet e kam mbushë me beton por edhe me kube por prapë po prishet kjo rrugë.

Avni Melenica, banor i Vushtrrisë, vjet kemi biseduar për shtëpinë e Kahrimanit ku është bërë masakra. Pata dëshirë me ditë deri ku kanë shkuar punët për kthimin e saj në muze.


Igballe Llapashtica, banore e Vushtrrisë, ne kemi problem me një shpronësim të mullirit. Qysh në vitet më të hershme e kanë marrë. Ne e kemi një dyqan dhe ne për mullirin po paguajmë tatim kurse për dyqanin që është pronë e jona në emër të prindit nuk po paguajmë. Unë kisha pas dëshirë që të paguajmë tatim për dyqan, të legalizohet në emër tonë dhe mullirin le te heqin.

Murat Bunjaku, banor i fshatit Samadrexhë, e vetmja lagje e jona që nuk ka ndriçim.

Takimi me qytetarë përfundoi në ora 12:40.


Procesmbajtëse:

Blerina Neziri



Kryetari i Komunës së Vushtrrisë

Ferit Idrizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtri



Lista e pjesëmarrësve

Takimi i parë publik me qytetarë

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës

Datë: 26.06.2026

Ora: 11:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
1	Fehmi Shola		Stonoc i Gërm
2	Ramadan Dauti		Mihalig.
3	Agim Dauti		Dobrovluk
4	Avni Melemica		22 maji - Xushtri
5	Ilirija Hoxhi		Stonoc i Gërm
6	Mosmail Hoxhi		Vushtri
7	Ilirija Hoxhi		Vushtri
8	GAZMEND	CURRI	PERVILK.
9	Mr. Fegji	Osmoni	M. Gonenjari
10	Mustafa Hoxhi	Vushtri	Vushtri
11	Faik Korina	Pantia	Pantia
12	Behar Merina	Pantia	Pantia
13	Samir Hoxhi	Pantia	Vushtri
14	Qemil Hasani	Hasani	Smolekomoc
15	FATUM Hoxhi		VUSHTRI



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtri



Lista e pjesëmarrësve

Takimi i parë publik me qytetarë

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës

Datë: 26.06.2026

Ora: 11:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
16	Bekim Çuni		Ali Pash Tepelenë nr. 14-12- Vushtrri
17	Samir Ferizi		Prill BASHI KUÇI TE RRETHI I FENIUKIT
18	IGDALI Llapashtica	J. Llapashtica	"HESH SHAHIN KRASHIÇI" BANESA KATI 4 . NR. 23
19	Adil Jusufi		Vushtrri
20	Orsahim Manca	B. Manca	Dubova Kufitar
21	Vidone Mulaku		Vushtrri
22	Enxhete Meng	N. Meng	Vushtrri
23	Hajret Shala	H. Shala	Vushtrri
24	HUSHI SHABANI		NOVOLAH
25	Murat Bunjaku		Zapodexh
26	BASHI KASTRATI		
27	Fikrije Ferizi	Ferizi "ATO"	Vushtrri
28	DRILON JUSUF		VUSHTRRI
29	Bleima Neri		VUSHTRRI
30	Hyrie Uca Hoxha	H. Uca	Vushtrri